

Raport paraprak



Ndarja administrativo-territoriale

Për të realizuar një Reformë Territoriale, është e nevojshme të njihet historiku i reformave të realizuara dhe proceset e kaluara që kanë sjellë në ndarjen territoriale aktuale.

- Riorganizimi territorial i miratuar me **Ligjin nr.8653/2000** “Për Ndarjen Administrative dhe Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore, ruajti kufijtë historikë të bashkive, komunave, rretheve apo prefekturave duke shkrirë kufijtë administrativë të rretheve për të krijuar ato të qarqeve.
RUHEN KUFIJTE EKZISTUES TË BASHKIVE DHE KOMUNAVE DHE **BASHKOHEN RRETHET PER TE KRIJUAR QARQET**
- Në vitet në vijim kemi vetëm një rast të ndryshimit të ndarjes territoriale, që erdhi si bashkim vullnetar i **Komunës së Barbullushit me atë të Bushatit** në Qarkun e Shkodrës, duke krijuar **Komunën e Bushatit** (nëpërmjet miratimit të **Ligji 9123/2003**)
MEGJITHËSE I VETMI BASHKIM VULLNETAR, SËRISH PËRBËN NJË BASHKIM QË MUND TË SHËRBEJË SI **SHEMBULL I MIRËKËPTIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PËR BASHKIM POTENCIALESH DHE KAPACITETESH PËR NJË NJËSI MË EFEKTIVE DHE EFICENTE NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT.**
- Nga **viti 2003 dhe deri në vitin 2013 kemi hapje dhe rihapje diskutimesh dhe shprehje të nevojave për një Reformë Administrative Territoriale**
 - Në **vitin 2004** kemi një dokument politik i përgatitur prej **Këshillit të Europës**. Bazuar tek ky dokument, u hartua një draft ligj për riorganizimin administrativo-territorial të vendit. Projektligji përcaktonte një sërë kriteresh, që në thelb synonin plotësimin e objektivit të sipër përmendur për njësi të qeverisjes vendore të afta të gjenerojnë të ardhura dhe të ofrojnë në mënyrë eficiente funksionet e përcaktuara nga ligji. **Draft ligji nuk gjeti konsensusin politik dhe si i tillë nuk u miratua nga parlamenti.**
 - **Banka Botërore ndërmorri një tjetër vlerësim të thellë të Decentralizimit të Qeverisjes** në Shqipëri dhe propozoi një sërë reformash në lidhje me decentralizimin administrativ e fiskal si dhe reformën territoriale, ku mes të tjerash spikat rekomandimi për shpërndarjen asimetrike të funksioneve dhe përgjegjësisve të NJQV-ve bazuar në kapacitetet njerëzore dhe fiskale individuale të tyre.
 - **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE)**, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) dhe Instituti Suedez për Administratën Publike (SIPU) në **vitet 2005 – 2006** risollën në vëmendje nevojën për reformën administrativo territoriale, duke e lidhur atë me zhvillimin rajonal dhe krijimin e rajoneve ekonomike, duke e konsideruar këtë edhe si një prej parakushteve në procesin e integritimit në Bashkimin Europian (BE).

- **Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP)** financuar nga Agjencia Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar e (USAID), në vitin 2012, risolli sërish në vëmendje nevojën për reformën administrative duke e lidhur atë ngushtësisht me përmirësimin e decetralizimit në qeverisje dhe përmirësimin në ofrimin e shërbimeve vendore.
- **Programi për Zhvillimin Rajonal financiar prej Agjencie Austriake dhe Zvicriane për Zhvillim (ADA & SDC)** e pasuron diskutimin në lidhje me nevojën për reformë territoriale dhe administrative, duke u fokusuar në rolin e nivelit të dytë të qeverisjes vendore, e duke analizuar thellësisht qeverisjen nën-kombëtare nga pikëpamja e qeverisjes në shumë nivele dhe e rajonalizimit.
- Edhe vetë **Shoqata e Komunave të Shqipërisë (SHKSH)**, që përfaqëson njësitë e klasifikuara si komuna, konsideronte si emergjente nevojën për një Reformë Administrativo Territoriale. **Financuar prej Agjencië Suedeze për Zhvillim (SIDA)** në 2012, kjo shoqatë i shtoi diskutimit edhe një tjetër studim, i cili bazuar në kontributet e studimeve paraardhëse, **vjen me rekomandime për reformë administrativo territoriale në nivelin e parë të qeverisjes.**

Nevoja për rishikim të ndarjes territoriale me fokus në zvogëlimin e numrit të NJVQV dhe krijimin e njësite të mëdha me mundësi reale konsolidimi dhe ofrimi shërbimesh cilësore, ishte teme diskutimi për të gjithë aktorët lokalë, qendrorë dhe organizatave vendase dhe ndërkombëtare.

Situata e qeverisjes vendore përbënte një shqetësim real dhe nevoja për reformim pranohej nga të gjithë, ndërkohë që në lidhje me mënyrën e realizimit të saj opinionet ishin të ndryshme.

Fragmentimi i madh dhe mungesa e kapaciteteve të njësite më të vogla në drejtim të ofrimit të shërbimeve kishin penguar vit pas viti zhvillimin e një qeverisjeje të mirë vendore, demokratike dhe në shërbim të komunitetit.



- **Reforma Administrative Territoriale e vitit 2014 është pa asnjë diskutim reforma më e rëndësishme në riorgaizimin e njësite të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, me efekte jo vetë në vetëqeverisjen vendore, por në të gjitha fushat e jëtës së komunitetit.**

Kjo Reformë synoi :

- ✓ Riorganizimin e NJVQV në njësi autonome, të konsoliduara financiarisht dhe të afta në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre të ngarkuara nga ligji.
- ✓ Krijimi i një administratë vendore të aftë dhe me kapacitetet e nevojshme për realizimin e misionit të vetëqeverisjes vendore mbështetur në transparencën dhe llogaridhënien ndaj komunitetit.
- ✓ **Rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbimet publike** vendore të ofruara nga NJVQV dhe përmirësimin e cilësisë së ofrimit të këtyre shërbimeve.

- ✓ Konsolidimin territorial **me qëllim mundësimin e decentralizimit, të delegimit të më shumë funksioneve, kompetencave** dhe shërbimeve tek qeverisja vendore ku nëpërmjet njësisive më të mëdha të qeverisjes vendore, të sigurohen më shumë kapacitete, të ushtrojnë një gamë më të madhe funksionesh dhe shërbimesh publike si dhe të ofrojnë mundësi më të mëdha promovimi të demokracisë vendore.
- ✓ Konsolidimin territorial me qëllim **krijimin e një ekonomie shkalle**, të munguar deri tani, që do të mundësonte që njësitë më të mëdha të qeverisjes vendore të ofrojnë shërbime më të efektshme dhe me kosto më të ulëta.
- ✓ Krijimi i mjediseve dhe kushteve sa më të mira për qytetarin dhe biznesin nëpërmjet **rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike të shoqëruara me rritjen e burimeve financiare** për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- ✓ Krijimi i mundësive reale për investime strategjike të munguara në nivel vendor si dhe mbështetjen e NJVQV në **realizimin e rolit të tyre aktiv në zhvillimin e ekonomik vendor**.



Për realizimin e Reformës Administrative Territoriale u ndoqën hapat si vijon :

- U përcaktuan kriteret për bashkitë e reja (kriteri kryesor ishte Zona Funktionale)
- U realizua studim i plotë dhe i thelluar i Zonave Funktionale
- U përgatit një program pune që do të shoqëronte procesin e ndarjes së re territoriale
- U realizua paralelisht konsultimi publik i gjërë që konkludoi me vendimin për riorganizimin e 373 bashkive dhe komunave në 61 bashkitë e reja

Studimi i zonave funksionale i parapriu ndarjes territoriale të vitit 2014.

Zona funksionale është një koncept që paraqet teorikisht ekzistencën reale të një hapësire ku **ndërveprimet ndërmjet banorëve të një territori dhe bashkëpunimet me strukturën institucionale (aktorët e qeverisjes locale apo qëndrorë) janë të shpeshta dhe të dendura**. Të tilla bashkëveprime janë për shëmbull ato të banorëve me administratën e qeverisjes vendore, rajonale dhe qëndrore, ndërveprimet e karakterit ekonomik me njësitë e punësimit privat apo publik në sektorë të ndryshëm si industry, bujqësi, shërbime etj.

Përpara se të propozohet krijimi i një NJVQV të re, nevojitet të kryhen analiza dhe studime të thelluara.

- Nevojitet një studim i detajuar i ZF Zonës Funktionale ku të jepen në mënyrë të përmbledhur fakte rreth ekzistencës reale të saj, të ilustruara nëpërmjet **analizës së territorit, burimeve natyrore, relievit, tokave, pyjeve dhe kullotave, burimet ujore, klima, historia dhe kultura, traditat, atraksionet e zonës, zhvillimeve demografike dhe sociale, burimet, tregjet dhe ndërveprimi ekonomik në këtë zone**.

- Ekonomia e Zonës Funktionale nevojitet të merret në analizë me qëllim përcaktimin e **karakteristikave dhe prirjeve të zhvillimit ekonomik të ZF**. Kjo analizë ka për qëllim të argumentojë përse ZF është një realitet dhe mund të zhvillohet si e tillë në të ardhmen duke u bazuar në analizën e avantazheve konkurruese dhe të vlerës së shtuar. **Analiza e tregut të punës, e punësimit dhe nivelit të papunësisë, e sektorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik si industrisë, industrisë minerare, asaj hidroenergjitike, turizmit, bujqësisë, blegtorisë, etj. nevojitet të përcaktojë aftësinë e konkurimit në treg të kësaj zone dhe zhvillimit të mëtejshëm.**
- **Analiza e Shërbimeve për ZF** nevojitet gjithashtu të përcaktojë shërbimet publike të ofruara në nivel lokal në bazë të tipologjisë së funksioneve aktuale të qeverisjes vendore duke kaluar në rekomandime në lidhje me të ardhmen në kontekstin e reformës administrative dhe territorial. Gama e shërbimeve që kanë nevojë të analizohet është shumë e gjërë dhe përfshin: **burimet ujore të mjaftueshme për garantimin e shërbimit të ujësjellësave dhe kanalizimeve, për garantimin e ujit për vaditje, për mundësinë e mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve urbane dhe inerteve, për garantimin e shërbimit të transportit, për ekzistencën e rrugëve dhe mundësinë e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së tyre, për garantimin e objekteve shkollore për kopshte dhe shkolla, etj.**
- **Analiza Organizative** është një përpjekje për të dhënë disa rekomandime mbi strukturën e ardhshme të njësive të reja të qeverisjes vendore mbi bazën e strukturave ekzistuese organizative dhe nevojave aktuale të zhvillimit. Analizimi i nevojave për burime njerëzore të kualifikuara të afta për administrimin e NJVQV dhe ofrimin e shërbimeve cilësore përbën një element kyc. **Identifikimi i kapaciteteve ekzistuese në zonë**, nëse ata janë lokalë apo vijnë nga zona të tjera për të plotësuar kapacitetet e munguara, përbëjnë një informacion të rëndësishëm që duhet analizuar. Evidentimi i burimeve njerëzore të kualifikuara të zonës, që ofrojnë shërbime në të tjera zona, është gjithashtu i një rëndësie të vecantë për të parashikuar funksionimin administrativ të njësive të reja.
- **Hartimi i projekteve për mbështetjen e zhvillimit të ardhshëm të ZF** nevojitet të përmbledhë plotësimin e nevojave të evidentuara dhe të cilat janë të mundura të realizohen në afat të shkurtër, të mesëm apo të gjatë me burime të vetat apo të donatorëve. Duhet mbajtur parasysh sidomos urgjenca e projekteve të zhvillimit për njësitë e reja të qeverisjes vendore në kontekstin e ri të krijuar si pasojë e reformës administrative dhe territoriale. **Qëllimi i këtyre projekteve është që të realizohet rritja e mbulimit të popullatës me shërbime publike më efektive (si pasojë e ekonomive të shkallës) dhe cilësore, garantimi i ruajtjes së nivelit aktual të ofertës së shërbimeve publike, mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe të qëndrueshëm dhe ruajtjes dhe forcimit të kulturës dhe traditës lokale**

Zbatimi i Reformës Administrative Territoriale në vitin 2014 u parapri nga një plan i detajuar masash mbështetëse me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve, bashkimin e njësive dhe konsolidimin e Bashkive të reja



Mbështetja për zbatimin e Reformës

Ndër hapat kryesorë të ndërmarra në mbështetje të bashkive të reja të krijuara pas reformës mund të përmëndim:

- Qeveria krijoi në strukturën e vet **pozicionin e Ministrit të Shtetit për Cështjet Vendore**, i krijuar për të udhëhequr dhe zbatuar jo vetëm Reformën Administrative Territoriale por edhe për mbështetjen e 61 bashkive të reja dhe 12 qarqeve në procesin e amalgamimit dhe më tej të konsolidimit të tyre përbënte një faktor të rëndësishëm vecanërisht në momentet e para të zbatimit të saj..

Ministri i Shtetit për Cështjet Vendore ishte vendimtar në mobilizimin e mbështetjes thelbësore të partnerëve ndërkombëtar për mbështetjen e Reformës Territoriale, përfshirë krijimin e një fondi me shumë donator për mbështetjen e RAT-së (**projekti STAR**) i menaxhuar nga UNDP, i cili dha mbështetje thelbësore të drejtpërdrejtë për procesin e shkrirjes dhe mes të tjerash bërjen operative të praktikave të reja dhe modeleve në bashkitë e reja. **Partnerë të tjerë si DLDP-ja e financuar nga Zvicra, USAID PLGP** gjithashtu dhanë një mbështetje të rëndësishme për bashkitë dhe procesin e reformës së decentralizimit.

Vazhimesia e projektit në fazat e tjera **Star2 dhe Star3** tregon jo vetëm interesin e Qeverisë për mbështetjen dhe konsolidimin e 61 bashkive të reja, por edhe **angazhimin e institucioneve ndërkombëtare në një proces të vazhdueshëm demokratizimi dhe konsolidimi të bashkive pas Reformës Territoriale.**

- Në ligjin e Buxhetit të Vitit 2015 (dhjetor 2014) u parashikua krijimi të **Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale** (sot Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore) menjëherë pas miratimit të Reformës Territoriale i parapriu zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Kjo Agjenci ka luajtur një rol kyç në koordinimin e reformës dhe më pas në dhënien e mbështetjes së drejtpërdrejtë për NJVQV.

Ajo u krijua me **VKM nr. 83, dt. 28.01.2015** “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale”, filloi akti vitetin në Mars 2015 dhe kishte si mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

- Kalimi nga 373 bashki dhe komuna në 61 bashki të reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 u realizua **pa ndërprerë për asnjë moment funksionimin e bashkive dhe të shërbimet ndaj qytetarëve.**
- Ndihej në hartimin e **Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Vetëqeverisje vendore 2015-2020.**
- Realizoi koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe **hartoi raporte dhe analiza periodike mbi këto çështje;**
- AZRT udhëhoqi procesin e **decentralizimit të funksioneve të reja** drejt 61 bashkive duke ofruar këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të reja, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse.
- **Miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015 – 2020** konsiderohet si një hap i rëndësishëm për hartimin e një **programi pune** mbi të cilën do të hidheshin hapat e parë drejt konsolidimit të bashkive të reja.

Strategjia dhe plani i veprimit në zbatim të saj parashikon një sërë risish në mbështetje të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

Si një program pune ambicioz për mbështetjen e 61 bashkive të reja të krijuara pas reformës

- Me qëllim përmirësimin e legjislacionit bazë dhe plotësimin e nevojës për një ligj të ri organik për vetëqeverisjen vendore, pas miratimit të RAT, **miratimi i Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, shënon një tjetër hap drejt mbështetjes së NJVQV. Ligji i ri rezulton i përmirësuar ndjeshëm krahasuar me Ligjin nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” duke krijuar më shumë hapësira për NJVQV, **duke zgjeruar fushën e veprimtarisë, të funksioneve dhe kompetencave të vetëqeverisjes vendore**, duke synuar konsolidim dhe një qeverisje më të mirë vendore në shërbim të komunitetit.

Ligji ndihmon gjithashtu në përcaktimin e **funksioneve dhe kompetencave të strukturave të reja të krijuara pas reformës Territoriale që janë Njësitë Administrative dhe administratorët**, si dhe kujdeset për vijimin e aktivitetit të tyre për tre vitet e para me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve.

- Për herë të parë vetëqeverisja vendore ka një ligj të posacëm për financat vendore, **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”** i cili krijoi për herë të parë mundësi të reja për fuqizim dhe konsolidim financiar të bashkive.

Disa nga risitë që sjell ky ligj janë:

- ✓ **Rritja e madhësisë së transfertës së pakushtëzuar** duke filluar nga viti 2018 dhe në vijim me mbi 30%.
 - ✓ **Lidhja e madhësisë së transfertës së pakushtëzuar me një variabël makroekonomik**, dhe më specifikisht **jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto**, dhe jo më pak se transfertat e ndarë një vit më parë;
 - ✓ Rritja e parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare nëpërmjet **aplikimit të formulës**;
 - ✓ **Ndarja për herë të parë e 2% e të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale** me bashkitë dhe rritja e normës së ndarjes së të ardhurave nga **taksa e automjeteve për bashkitë nga 18% në 25%**;
 - ✓ Forcimi dhe harmonizimi i rregullave për procesin buxhetor dhe **disiplinën fiskale e financiare në menaxhimin e financave vendore**, si dhe forcimi i rolit më të madh mbikqyrës dhe koordinues të Ministrisë së Financave në këtë drejtim;
 - ✓ Rregullimi i procedurave për menaxhimin e situatave të bllokimit të miratimit të buxheteve nga këshillat e vetëqeverisjes vendore.
 - ✓ Krijimi i mundësisë për **aplikimin e taksave të përkohëshme** për përmirësimin e shërbimeve problematike.
- Kryerja e reformës Administrativo-Territoriale krijoi kushte për **decentralizim të funksioneve të tjera drejt bashkive të reja**. Ndërsa copëzimi në njësi të vogla kishte qënë pengesë reale dhe kishte ndaluar prej vitesh procesin e decentralizimit, kryerja e reformës dhe reduktimi i numrit të bashkive në 61, krijoi kushte për vijim të procesit të decentralizimit. Në zbatim të SNDQV 2015-2020 dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, realizimi në vitin 2016 dhe në vijim i decentralizimit të disa funksioneve të reja drejt bashkive ka synuar rritjen e përgjegjësisë të tyre ndaj komunitetit kryesisht në fushat :

- **Shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit**
- **Arsimi parashkollor**
- **Mirëmbajtja e rrugëve rurale**
- **Administrimi i pyjeve dhe kullotave**
- **Ujitja dhe kullimi**
- Shërbime të tjera që lidhen me **administrimin e qendrave sociale, qendrave sportive, konvikteve të shkollave dhe iniversiteteve, etj.**

Fillimi i menjëhershëm (vetëm 6 muaj pas fillimit të punës nga të zgjedhurit e rinj vendorë) i procesit të decentralizimit, tregon seriozitetin dhe përkushtimin e Qeverisë për decentralizim të vazhdueshëm dhe rritjen e funksioneve dhe kompetencave të NJVQV në ofrimin e më shumë shërbimeve ndaj qytetarëve.

- **Plotësimin dhe hartimin e legjislacionit të ri sektorial** për funksionet e reja të bashkive, por edhe për funksione të tjera të ndikuara nga zbatimi i reformës Administrative Territoriale ishte një proces kompleks që realizoi
 - ✓ Miratimi i ndryshimeve ligjore të **Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”** realizoi rishikimin e funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile duke i përshtatur me ndarjen e re administrative territoriale.
 - ✓ Me qëllim realizimin e decentralizimit të funksionit tek NJVQV, u miratua **Ligji Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”**, i cili u shoqërua me miratimin e VKM nr.366,dt.18.05.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”.
 - ✓ Miratimi i **Ligjit nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit"** përmbylli procesin e plotë të decentralizimit të këtij funksioni që u vijua me hartimin dhe miratimin në **Maj 2017 të Strategjisë së ujitjes dhe kullimit në Shqipëri**, financuar nga Banka Botërore që parashikon rritjen e sipërfaqes që ujitet nga 220 000 ha drejt sipërfaqes potenciale ujitëse prej 360,000 ha, për periudhën 2018- 2027.
Me miratimin e VKM nr. 1108, date 12.30.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve të kullimit” u finalizua transferimi i funksionit të ujitjes dhe kullimit tek 61 bashkitë e reja
 - ✓ **Me VKM 63, datë 8.3.2016 u aprovua transferimi 100% i pyjeve dhe kullotave tek 61 bashkitë e reja**, duke shfuqizuar mbi 300 VKM të mëparshme për transferimin tek ish-komunat. Aprovimi i këtij vendimi i hapi rrugë menaxhimit të aseteve nga ana e bashkive të reja dhe mundësimin e përdorimit të tyre më shumë në funksion të ekonomive lokale. (Në kuadër të decentralizimit të plotë të funksionit të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është hartuar baza ligjore që mundësoi transferimin e funksionit. Me transferimin e funksionit në NJQV, **82.3% e sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullor ka kaluar në administrimin e Bashkive, 15% e sipërfaqes i përket zonave të mbrojtura dhe 2.7% janë pyje private.**

Ka filluar dhe është në proces rregjistrimi i fondit pyjor në kuadër të unifikimit të regjistrit kadastral kombëtar, duke bërë të mundur regjistrimin në fazën e parë të 250,000 ha, dhe duke vazhduar më tej me regjistrimin e rreth 750,000 ha pyje dhe kullota).

- ✓ Përfundoi me sukses **inventarizimi dhe riklasifikimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke krijuar inventarin e rrugëve rurale për cdo bashki** si dhe duke saktësuar rrjetin rrugor nën administrim të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
- ✓ U aprovuan ndryshimet përkatëse në Ligjin nr. **10/2016 “Për transportet rrugore”** të cilat përcaktojnë funksionet e reja në drejtim të shërbimeve të transportit rrugor duke shtuar kompetencat në administrimin e transportit brenda territorit të bashkive si dhe duke përmirësuar organizimin e shërbimit.
- ✓ Në fushën e mbetjeve urbane u hartua **Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2017-2024)**.
- ✓ Ndryshimi në vitin 2018 të **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSh”** finalizuan procesin e transferimit të funksionit të arsimit parashkollor, duke i kaluar bashkive të drejtën e emërimit të drejtuesve / mësuesve të arsimit parashkollor si dhe personelin jomësor në institucionet e arsimit parauniversitar.
- ✓ U miratua **Ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH”**, i cili rregullon mekanizmat institucionale, rolin dhe përgjegjësitë e bashkive për zbatimin e sistemit të shërbimit të kujdesit shoqëror. Është kryer rishikimi i Sistemit të Ndhmës Ekonomike dhe Pilotimit dhe në vijim u miratua Vendimi nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”.
- ✓ U siguroi që në ditët e para të punës së bashkive të reja **mbështetja ndaj bashkive për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për realizimin e vlerësimeve të punës nga NjVQV**. DAP vuri në dispozicion të bashkive manualet dhe udhëzimet për vlerësimin e punës dhe sistemin e klasifikimit të vendeve të punës i dedikuar për NjVQV. U realizua trajnimi për vlerësimin e arritjeve në punë për stafet e NJMBNJ të bashkive me mbështetjen e një projekti të KiE, i cili ofroi një program trajnimi të avancuar, me qëllim që të mundësohej kryerja e vlerësimit të arritjeve në punë për administratën vendore të 61 bashkive.
- **Krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore**, solli për herë të parë një instrument real të garantimit të konsultimit ndërmjet dy niveleve qeverisëse, në funksion të mbrojtjes së autonomisë vendore dhe kujdesit për mos cënim të saj në vendimmarrje.

Akte nënligjore në zbatim të cdo ligji sektorial dhe me qëllim detajimin dhe saktësimin e tyre, u miratuan dhe u vunë në dispozicion të NJVQV si dhe të institucioneve qendrore.

Reforma Administrativo-Territoriale u miratua me Ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” duke

reduktuar numrin e NJVQV nga **373 bashki dhe komuna në 61 Bashki**, që përbëjnë edhe nivelin e parë të vetëqeverisjes vendore. Ish NJVQV që u shkrinë, u organizuan në formën e **Njësie Administrative**, si pjesë përbërëse dhe në vartësi të bashkive që ju përkasin.

Numri i Këshillave të Qarqeve nuk ndryshoi, pra Shqipëria vazhdon të **ketë 12 Këshilla Qarqesh**, që përbëjnë nivelin e dytë të qeverisjes vendore.



Propozimi për rishikim të ndarjes Administrativo-Territoriale

Sot jemi pak më shumë se 7 vite nga zbatimi i Reformës Territoriale të vitit 2014 dhe është shtruar për diskutim çështja e rishikimit të ndarjes territoriale.

Për këtë qëllim është ngritur dhe Komisioni i Posaçem për Reformën Administrativo Territoriale.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo- Territoriale në Republikën e Shqipërisë është shoqëruar edhe me përcaktimin e objektit të veprimtarisë së tij:

- a) përcaktimin e **kritereve për ndarjen e re** administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë – **NUK ËSHTË REALIZUAR !!**
- b) hartimin dhe përcaktimin e **kalendarit të zbatimit të reformës** administrative-territoriale; - **NUK ËSHTË REALIZUAR**
- c) **përgatitjen e projektit për ndarjen e re** administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

PROPOZIMI - REALIZUAR !!

Nuk janë ndjekur hapat e duhur sipas parashikimit të objektit të punës së komisionit. Madje duket se afër përfundimit të afatit të punës së komisionit, është hedhur hapi i fundit, pa kaluar më parë dy të tjerët.

Si ekspertë ne nuk kemi asnjë të drejtë të vlerësojmë punën e Komisionit, por vlerësojmë se pa përcaktuar më parë kriteret dhe kalendarin e zbatimit të ndryshimeve territoriale, nuk mund të ketë rishikim të ndarjes territoriale.

Përmendëm hapat e ndjekur për realizimin e Reformës Territoriale të vitit 2014, sepse realizimi i saj eci në rrugën e duhur : përcaktim kriteresh, studim i zonave funksionale, plan mbështetje për reformën, konsultim publik dhe vendim për ndarje Administrative Territoriale.



Ngritja e komisionit dhe rishikimi i ndarjes territoriale u kërkua nga opozita. Pretendimet e prezantuara nga ana e përfaqësuesve të opozitës në komision, janë si vijon:

- ✓ Reforma Administrativo-Territoriale e miratuar me Ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, nuk

ka patur asnjë efekt pozitiv ! **Ajo është një reformë totalisht e dështuar!** Reforma duhet rishikuar totalisht !

- ✓ **Miratimi i reformës ka qënë i njëanshëm** dhe si e tillë ajo është bërë për përfitime elektorale dhe duhet rishikuar me qëllim shmangien e efekteve elektorale që ajo përmban.
- ✓ **Asnjë nga objektivat për të cilat u realizua reforma që nuk është arritur.** Situata e bashkive është përkeqësuar në të gjitha drejtimet dhe konkretisht:
 - **Numri i punonjësve të bashkive është dyfishuar** ndërkohë që pritej ulja e numrit!
 - **Shpenzimet administrative janë rritur** ndërkohë që pritej të kurseheshin financat vendore!
 - **Shërbimet janë përkeqësuar** në të gjithë vendin, **vecanërisht në zonat rurale** të ish komunave ku nuk ofrohen shërbime fare ose ka përkeqësim.
 - **Situata financiare e bashkive është përkeqësuar** dhe bashkitë po falimentojnë.
 - **Autonomia financiare e bashkive është dobësuar** dhe bashkitë varen nga mbështetja e qeverisë dhe nuk sigurojnë të ardhura të vetat.
 - **Bashkitë kanë më pak kompetenca** se para Reformës dhe jo vetëm që nuk ka ndodhur decentralizim, por funksionet janë centralizuar.
- ✓ Numri i bashkive është i vogël dhe kjo **ka larguar banorët e zonave rurale nga qendrat e bashkive duke sjellë mungesë përfaqësimi të tyre.**
- ✓ **Bashkitë e vogla performojnë më mirë**, ofrojnë shërbime më të mira dhe janë më afër komunitetit
- ✓ **Banorët e Njësive Administrative dhe zonave rurale nuk janë të përfaqësuar në organet e qeverisjes vendore (Këshillat Bashkiake)** dhe as në administratën vendore.
- ✓ **Investimet e bashkive janë përqendruar në qytete** duke anashkaluar NJA dhe zonat rurale
- ✓ **Këshillat e Qarqeve janë struktura që nuk luajnë asnjë rol.**

Jemi përpjekur të bëjmë një vlerësim të situatës së pasreformës territoriale, duke u përpjekur të dallojmë funksionimin e 61 bashkive të reja krahasimisht më 373 ish bashkitë dhe komunat e para vitit 2015.

Për aq kohë sa **nuk ka një vlerësim të plotë dhe të pavarur** as për performancën e bashkive krahasuar me ato të parareformës, dhe as të efekteve të reformës në këtë performancë, Jemi përpjekur të bëjmë një vlerësim të Reformës Administrative Territoriale duke u bazuar :

- Në të **dhënat e institucioneve shtetërore** (kryesisht Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë)
- Në të **dhënat e raporteve të pjesëshme**, për çështje të vecanta dhe për bashki specifike të institucioneve dhe organizatave të ndryshme.
- Në **konsultimin e organizuar me përfaqësues të OSHC, ekspertë dhe aktorë të tjerë** me përvojë dhe kontribut në vetëqeverisjen vendore.

Gjithashtu SHAV dhe SHKQSH përfundoi para disa javësh realizimin e një **pyetësori me 91 pyetje** me kryetarë bashkie dhe këshillash bashkiake, kryetarë qarqesh, drejtues vendorë, ish kryetarë bashkie **përfaqësues të opozitës, me pjesëmarrjen e 236 personave.** Rezultatet e

pyetësorit u prezantuan për diskutim **në 11 takime rajonale** me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe ish kryetarëve të bashkive, të këshillave të qarqeve dhe të këshillave bashkiake, duke hapur diskutime në lidhje me nevojat për mbështetje të NJVQV në kuadër të konsolidimit të tyre.

Rezultatet dhe raporti me analizën përkatëse i është prezantuar gjithashtu edhe Ministrisë së Brendëshme

Pothuaj të gjithë raportet, rezultatet e pyetësorëve dhe vlerësimet e organizmave ndërkombëtarë dhe organizatave vendase më kontribut në mbështetjen e NJVQV, mbizotëron **opinionin që vlerëson se objektivat kryesorë të Reformës Territoriale përgjithësisht janë arritur me sukses, krahas theksimit të nevojës për konsolidim dhe përmirësim të mëtejshëm të performancës së 61 bashkive të reja.**

Aktorët si në nivelin qendror ashtu dhe në atë vendor, organizatat vendase dhe të huaja, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, besojnë se :

- Reforma Administrativo Territoriale e realizuar në vitin 2014 **ishte e domosdoshme** për t'i dhënë vetëqeverisjes vendore një frymëmarrje të re dhe hapësira më të mëdha vetëqeverisëse në shërbim të komunitetit.
- Reforma Administrative Territoriale e realizuar në vitin 2014 **u mbështet nga të gjithë partnerët ndërkombëtarë** nëpërmjet programeve të hartuara bazuar tek nevojat dhe të zbatuara në bashkëpunim me OSHC dhe të zgjedhurit vendorë me qëllim garantimin e suksesit të saj.
- Reforma Administrativo Territoriale konsiderohet që **ka arritur suksese të dukshme në drejtim të demokracisë lokale, të autonomisë vetëqeverisëse si dhe në përmirësimin e ndjeshëm të performancës së NJVQV**
- **Konsolidimi i NJVQV është një proces i vazhdueshëm** që kërkon mbështetje të mëtejshme dhe angazhim të të gjithë aktorëve vendas dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Një sërë arritjesh të rëndësishme kanë hedhur themelet për funksionimin e sistemit të ri të qeverisjes vendore që hyri në fuqi në 2015 duke përfshirë:

- **Burimet në dispozicion të qeverisjes vendore janë rritur ndjeshëm** gjatë viteve të fundit:
 - **Buxhetet e qeverisjes vendore** (dhe nga burimet e kushtëzuara dhe nga ato të pakushtëzuara) **janë rritur vit pas viti** në përputhje me objektivat e Strategjisë 2015-2020 dhe në vijim.
 - **Shuma e grantit të pakushtëzuar është rritur nga viti në vit** dhe duke filluar nga viti 2016 po përdoret një formulë e rishikuar e barazimit (ekualizimit) horizontal për transfertën e pakushtëzuar.
 - **FZHR vazhdon të jetë një burim i rëndësishëm i financimit për projektet më të mëdha të zhvillimit të infrastrukturës në nivelin e bashkive edhe pse vazhdon të jetë një instrument i politikës kombëtare.**
- Bashkitë përfitojmë më shumë të ardhura **jo vetëm nga taksat dhe tarifat vendore, por edhe nga taksat kombëtare:**

- **97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë** për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë i kalon bashkive.
- Niveli i ndarjes për **taksën e regjistrimit të automjeteve është rritur me 25%** të të ardhurave në favor të bashkive
- **5% e të ardhurave nga renta minerare**, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare i kalojnë bashkive
- **Tatimi mbi të ardhurat personale** u paraqitet sot si një taksë e përbashkët, **me 2% të të ardhurave në favor të bashkive.**
- Ndryshimet në **taksën mbi pronën**, duke kaluar në një sistem **me bazë vlere për taksën mbi ndërtesat**, është ndryshimi më i rëndësishëm në kuadrin rregullator për të ardhurat e njësisive të qeverisjes vendore nga burimet e veta.
- **Qeveria qendrore po punon për krijimin e një kadastre fiskale** për qëllimin e administrimit të taksës mbi pronën në nivelin vendor dhe ka parashtruar qëllimin e saj për të caktuar operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) si agjentin grumbullues për taksën mbi pronën.
- Përmirësime të konsiderueshme janë bërë në fushën e **funksioneve të veta.**
 - Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve **mbulimi i shërbimeve për largimin e mbetjeve është rritur nga 60% në mbi 80%** të territorit pas Reformës Territoriale.
 - Në arsimin parauniversitar, ndryshimi më i madh që është bërë si rrjedhim i strategjisë së decentralizimit dhe si rrjedhojë e ligjit të ri për vetëqeverisjen vendore ishte dhënia e **autoritetit të plotë bashkive mbi sistemin arsimor parashkollor (kopshtet).**
 - **Kuadri strategjik dhe ligjor për mbrojtjen sociale dhe shërbimet e kujdesit social është në përputhje me parimet e decentralizimit siç përcaktohet në SNDQV**, duke njohur rolin e njësisive të qeverisjes vendore në mbulimin dhe në mbështetjen e popullsisë së cenueshme
 - Mbështetja e infrastrukturës për bashkitë e reja përmes financimit direkt dhe përmes **Fondit për Zhvillimin Rajonal** ka vazhduar në përputhje me planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Vendore.
 - Është siguruar mbështetja e nevojshme për përgatitjen e **Planeve të Përgjithshme Vendore për të disiplinuar dhe mbështetur zhvillimin territorial dhe ekonomik të Bashkive.** Janë përfunduar dhe miratuar Planet e Përgjithshme Vendore për rreth 80% të bashkive dhe janë në proces miratimit ato të pjesës tjetër, duke plotësuar me Plane vendore të 61 bashkitë e vendit në një periudhë prej jo më shumë se 7 vitesh nga realizimi i Reformës Territoriale.
 - **Funksioni i sigurisë publike dhe vecanërisht shërbimi zjarrfikës i bashkive ka një përmirësim të ndjeshëm.** Ai ka sot 165 automjete zjarrfikëse dhe mjete të tjera ndihmëse. Nga momenti që ky shërbim u decentralizua këtij shërbimi iu shtuan 60 automjete dhe nga 105 automjete që kishte në vitin 2014, sot ka 165 mjete. Në 61 bashkitë në vend janë instaluar **70 stacione zjarrfikëse, nga 38 që ishin në 2014, me 1250 punonjës nga 749 që ishin në vitin 2014.**
 - Një rol të ri kanë marrë bashkitë në lidhje me **zhvillimin ekonomik vendor duke përdorur incentiva për mbështetjen biznesit të vogël dhe nxitjes së investimeve.** Zhvillimi ekonomik vendor nuk mund të shihet i ndarë nga bashkëpunimi dhe mbështetja e nevojshme nga Qeveria për realizimin e projekteve të përbashkëta. Në vitet e fundit janë

ndërmarrë një numër nismash të drejtuara dhe të financuara nga qeveria qendrore për zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal.

- **Krijimin e sporteve me një ndalesë** në 61 bashkitë e vendit dhe ofrimin në këto sportele të një numri shërbimesh që varion **nga 40 në 70 shërbime** të shpejta administrative, falë mbështetjes së donatorëve nëpërmjet **Projektit Star3**.
- Forcimin e dialogut dhe përgjegjshmërisë reciproke ndërmjet nivelit qendror dhe vendor të qeverisjes, nëpërmjet **funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore më Vetëqeverisjen Vendore (mbështetur nga USAID, KE dhe BE)**.
- Mbështetje e vazhdueshme është ofruar nga disa programe për NJVQV me qëllim **funksionimin efikas të organeve përfaqësuese, konsolidimin e njësive administrative, përmirësimin e bashkëpunimit ndër-vendor dhe ndër-institucional, përmirësimin e ligjit organik të qeverisjes vendore, etj.**
- **Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike (ASP)** në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol thelbësor në dhënien e modeleve të organizimit të brendshëm, përshkrimeve standarde të punës, si dhe programeve të trajnimit për kryetarët e rinj të bashkive. ASPA ka ofruar me prioritet trajnimet e detyrueshme të prurjeve të reja të shërbimit civil në nivel vendor. NJVQV-të këshillohen të përdorin platformën elektorale e-PAV për planifikimin e trajnimeve.
- Në element i rëndësishëm në kuadër të ristrukturimit të organizimit të strukturave të qeverisë qendrore në nivel rajonal dhe vendor (**d.m.th. strukturat e dekoncentruara**), **në përputhje me ndarjen e re territoriale**, është vëmendja që po tregohet në mënyrë që të lehtësohet ndërveprimi i lehtë dhe bashkëpunimi midis dy niveleve të qeverisjes.
- Progres i mëtjeshëm është bërë lidhur me përdorimin e mjeteve të TIK për ofrimin e informimit të publikut. **Numri i bashkive me faqe interneti është rritur vit pas viti duke siguruar sot që 61 bashki të kenë faqet e internetit dhe të publikojnë veprimtarinë e tyre në dispozicion të publikut.**
- Janë bërë më shumë përpjekje për të **ngritur kapacitetet e këshillave vendorë** që ata të ushtrjnë në mënyrë më të efektshme funksionet e veta mbikëqyrëse. Projekti Bashki të Forta i financuar nga Helvetas ka ofruar asistencën e nevojshme për 61 këshillat bashkiake. Sot **mbledhjet e këshillave bashkiake transmetohen live dhe aktet e këshillave publikohen në të 61 bashkitë**. Procesi i transparencës, i mbikqyrjes së veprimtarisë së ekzekutivit dhe i vendimmarrjes realizohen në bashkëpunim me strukturat komunitare të cilat luajnë një rol më aktiv.
- Procesi i integritit evropian ndikon mbi veprimet e këshillave vendorë, përderisa kuadri ligjor dhe rregullator, si dhe standardet për shërbimet e dhëna edhe në nivel lokal duhen sjellë në standardet europiane. **Projekti “Bashkitë për Europën” i financuar nga BE** ka dhënë një kontribut të cmuar në mbështetjen e NJVQV në kuadër të identifikimit të rolit të bashkive në procesin e integritit evropian.

Autonomia dhe kapacitetet financiare të 61 bashkive

Autonomia dhe Kapacitetet financiare të bashkive të reja janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të pas Reformës. Disa nga arritjet kryesore në konsolidimin financiar të bashkive pas Reformës Administrative-Territoriale, të shoqëruara me efekte pozitive në buxhetin vendor janë:

- Rritja e buxhetit në tërësi për pushtetin vendor, nga **2.1% të PBB-së** që ishte në vitin 2014 para Reformës, në **3.2% për qind të PBB-së** në 2021 dhe shpenzimet totale (së bashku me transfertat e kushtëzuara) kanë arritur në **5.8 % të PBB-së** për vitin 2021.
- Shpenzimet totale të pushtetit vendor janë rritur nga **34 miliard lekë** në vitin 2015, në **57 miliard lekë** në vitin 2021, ose **67.6%** më të larta.
- Bashkitë kanë një administratë vendore me **35%** më pak punonjës se në vitin 2014.
- **76%** më pak numër këshilltarësh të NJVQV (reduktim i numrit nga **6500** që ishin në 2014, në 1595 që janë aktualisht).
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë rritur mbi **2 herë (me 217 %** ose nga **11.7 miliard lekë** në vitin 2015, në **26.6 miliard lekë** në vitin 2021)
- Investimet e realizuara nga të ardhurat e NJVQV janë rritur mbi **3 herë**

Burimet Njerëzore të NJVQV

Të dhënat e paraqitura në këtë material, referuar të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, tregojnë :

- **Ulje të numrit të punonjësve të administratës** së NJVQV
- **Rritje të numrit të punonjësve institucioneve**, ndërmarrjeve dhe agjencive që ofrojnë shërbime publike direkte

Nuk ka asnjë studim të thelluar që të analizojë dhe t'i përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me çështjet në vijim:

- Sa ka qënë **numri i punonjësve që ofronin shërbime publike** për llogari të 373 ish bashkive dhe komunave, duke përfshirë edhe **numrin e punonjësve të kompanive të kontraktuara** nga ana e tyre para vitit 2015?
- **Si qëndron ky numur sot, krahasimisht me atë të ish bashkive dhe komunave**, duke llogaritur shërbimet që dikur ofroheshin nga palë të treta dhe sot ofrohen nga bashkitë dhe anasjelltas?
- Sa kanë ndikuar në rritjen e këtij numri punonjësish shërbimesh (nëse është një ritje reale) **mbulimi i një territori më të madh** (sa është ky territor krahasuar me territorin ku ofronin shërbime 373 ish bashki dhe komuna për cdo shërbim publik?) dhe **aplikimi i standarteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve** (kontratat e reja të shërbimeve publike janë të të njëjtit standart si në qytet ashtu edhe në pjesën tjetër të territorit)?
- Sa do të ishte numri i punonjësve të **ish bashkive dhe komunave sot, pas 7 vitesh**, sikur Reforma Territoriale të mos ishte realizuar (sa ka qënë rritja e natyrshme e numrit nga viti 2000

në vitin 2015 për ish komunat dhe bashkitë dhe sa do të ishte rritja e natyrshme e numrit pas 7 viteve?).

- Gjatë mandatit të parë **2015-2019, sa është rritur numri i punonjësve të shërbimit në secilën prej 61 bashkive, përfshirë edhe ato të drejtuara nga opozita dhe a ka qënë kjo rritje proporcionale me zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve? Sa është kjo **rritje në mandatin e dytë dhe a ka lidhje me përkatësinë partiake të drejtuesve të NJVQV ?**)**
- Si do të ishin shërbimet publike të ofruara nëse numri i punonjësve të shërbimit nuk do të kishte ndryshuar apo do të ishte ulur? A do të përballonte i njëjti numur punonjësish kërkesat në rritje për shërbime më të mira? **Kush është raporti që regullon numrin e punonjësve të shërbimit me cilësinë e shërbimit të ofruar?**
- Sa ka ndikuar **mungesa e opozitës në këshillat bashkiake**, në miratimin e numrit të punonjësve për administratën dhe institucionet në varësi dhe si mund të ishte ky numër nëse këshillat bashkiake do të kishin oponencën e nevojshme brenda tyre?
- A do të quheshin bashki më të mira dhe reforma më e suksesshme nëse **numri i punonjësve do të ishte më i vogël dhe performanca më e dobët?**
-

Ajo që është më e rëndësishme lidhet edhe me faktin nëse ulja e numrit të punonjësve të administratës apo rritja e numrit të punonjësve të shërbimeve publike, është efekt i Reformës Territoriale apo i faktorëve të tjerë ?

Të pyetur në lidhje me vlerësimin e reformës territoriale bazuar tek numri i punonjësve, të gjithë kolegët tanë ju përgjigjën se **“Numri i punonjësve të bashkive nuk mund të shërbejë si një tregues i suksesit apo dështimit të Reformës Territoriale”**.

Mbetet e paqartë nëse **numri i shërbyesve duhet konsideruar si një tregues pozitiv për sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, apo si kosto të shtuara për shërbimet**. Kjo gjë duhet analizuar **rast pas rasti** dhe ne nuk e kemi mundësinë për ta analizuar këtë gjë për cdo shërbim publik dhe për cdo bashki.

Të vlerësosh Reformën Territoriale bazuar tek numri i punonjësve të NJVQV është njësoj si të vlerësosh një studim, një analizë apo një raport vetëm nga numri i faqeve të tij !!

A mund të deklarojmë se Reforma ka dështuar sepse numri i punonjësve të shërbimeve publike të bashkive është rritur, ndërkohë që pritshmëritë e shumëkujt ishin që ky numur të ulej? Por le të vazhdojmë më tej arsyetimin :

Nëse nesër këshillat bashkiake mblidhen dhe marrin vendime të shkurtojnë numrin e punonjësve të bashkive duke përkeqësuar shërbimet, a do të thotë kjo se Reforma Territoriale nga e dështuar sot kthehet menjëherë nesër në një Reformë të suksesshme?

Gjithsesi disa të dhëna referuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mund t'i marrim në konsideratë :

Nëse do të analizonim efektet që ka patur reduktimi i njësive të vetëqeverisjes vendore në numrin e punonjësve të NJVQV nga viti 2014 dhe deri më sot, do të shohim ndryshime të pozitive që kanë shoqëruar procesin e konsolidimit të NJVQV dhe përmirësimin të performancës së bashkive të reja.

- Në vitin 2014, si viti para reformës administrative-territoriale rezulton se numri i punonjësve në administratën e bashkive/komunave ka qënë rreth **14,401**, ndërkohë që sot në 61 bashkitë e vendit ky numër është ulur në **9,585 punonjës**, pra është reduktuar me **4,816** punonës ose **rreth 35 %** më pak punonjës si pjesë e administratës. administrohej deri në vitin 2014 nga 14 zyra juridike dhe 14 zyra urbanistike! Të dhënat e MFE tregojnë se vetëm 12 bashki kanë rritur numrin e punonjësve të administratës për vitin 2021 krahasuar me 2014, ndërsa 49 të tjera e kanë ulur atë.
- Nëse do ti referohemi pjesës së numrit të punonjësve e cila lidhet drejtëpërdrejtë me ofrimin e shërbimeve rezulton se ka një rritje të numrit të tyre. Në vitin 2014 numëroheshin rreth 6200 punonjës që ofronin shërbime publike. Kryesisht në këtë periudhë për shkak të kapaciteteve të kufizuara, shërbimet publike ofroheshin nga kompani private të kontraktuara nga 373 bashki dhe komuna. **Nëse konsiderojmë numrin e punonjësve të kompanive privatë që ofronin këto shërbime**, madje me kosto të rritura që përfshinin edhe fitimin e kompanive, ky numër i punonjësve të shërbimeve pothuaj trefishohej.
- Ndërkohë që **të ardhurat janë rritur mbi 2 herë dhe shpenzimet për shërbimet publike janë rritur me 67.6%**, rritja e numrit të punonjësve që ofrojnë shërbime publike me 42% nga pikëpamja financiare është plotësisht e justifikuar.
- Ndryshimi i numrit të punonjësve me rritje nga viti 2014 në vitin 2021, të ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë së bashkive që lidhen drejtëpërdrejt me ofrimin e shërbimeve, vjen edhe si rezultat i disa faktorëve të tjerë ndër të cilët :
 - Ndryshimeve ligjore të cilat sollën edhe domosdoshmërinë për shtimin e burimeve njerëzore me rreth 10000 punonjës, me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore për ushtrimin e funksioneve të reja; Transferimit nga niveli qendror në nivel vendor të numrit të punonjësve **për shkak të shtimit të funksioneve të reja** të financuara nga transferata specifike si Arsimi Bazë dhe Parashkollor, Arsimi Parauniversitar (punonjësit jomësimesorë), MNZSH, Administrimi i Pyjeve, Menaxhimi Rrugëve Rurale, Qëndrat Sociale, Qendra Sportive, Korpuse Konviktesh Universitare, Ujitja dhe Kullimi etj.
 - **Krijimit të strukturave/ndërmarrjeve të reja** në varësi të bashkisë për të rritur standartin e ofrimit të shërbimeve apo për shërbime të reja, si përshëmbull ndërmarrje pastrimi, ndërmarrje gjelbërimi, agjenci mjedisi, njësi për promovimin e qytetit, qendra sociale, agjenci tregjesh, qendra sportive, agjenci parqesh rekreacioni, administrimi i plazheve, ndërmarrje administrimi parkimesh publike, etj;
 - **Zgjerimit të shërbimeve në sasi dhe cilësi** përbën një tjetër arsye të rritjes së numrit të punëtorëve të shërbimeve (shtrirje në të gjithë territorin e bashkisë e më shumë kopshteve dhe cerdheve, shtimi i territorit që pastrohet, më shumë mirëmbajtje për rrugët rurale, më shumë kujdes për administrimin e pyjeve dhe kullotave, administrimi i parqeve, i parkimeve publike, etj.).

Ne gjykojmë se nevojitet një vlerësim i plotë që kërkon kohën e nevojshme për të përcaktuar efektin e **përdorimit të instrumentave të ndryshëm në ofrimin e shërbimeve publike, të shtimit të funksioneve të reja, të përmirësimit të shërbimeve publike, të zgjerimit të**

territorit, të kostove të ofrimit të shërbimeve, të përdorimit dhe respektimit të standarteve kombëtare dhe standarteve vendore në ofrimin e shërbimeve, etj.

Cilësia e shërbimeve

Shërbimet publike në fund të fundit janë ato për të cilat banorët kanë nevojë dhe NJVQV janë ofruesit më të mëdhenj të këtyre shërbimeve.

Krahasimisht me vitin 2015 shërbimet publike të ofruara nga ana e bashkive **në përgjithësi kanë shënuar përmirësim** dhe kjo konstatohet në cdo raport vlerësues për shërbime të vecanta në bashki të vecanta. Se sa **ky përmirësim i dedikohet Reformës Territoriale, kjo mbetet për t'u analizuar.** Edhe nëse reforma nuk do të ishte realizuar në vitin 2014, sot pas 7 viteve do të kishim sërish përmirësim të shërbimeve publike dhe kjo për shkaqe të natyrshme që kanë të bëjnë me **efektin e ekonomisë së tregut, të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të vendit vit pas viti, fuqizim të qeverisjes vendore dhe kërkesave në rritje të komunitetit për shërbime më të mira.**

Opiniononi zotërues i të gjithë aktorëve, i komuniteteve dhe të zgjedhurve vendorë është që “Shërbimet publike të ofruara nga bashkitë janë përmirësuar diku më shumë dhe diku më pak, por në asnjë shërbim dhe në asnjë pjesë të territorit ato nuk janë përkeqësuar”.

Për të vlerësuar shërbimet publike nevojitet **të përcaktohen standartet përkatëse**, sasiore dhe cilësore, në nivel kombëtar (të konsideruara si standarte minimale) dhe në nivel lokal. Këto standarte duhet të shoqërohen **me tregues** që matin realizimin e standarteve të të gjitha dimensionet e tyre. Vlerësimi i shërbimeve do të mund të vlerësohet të paktën në dy aspekte:

- **Në plotësimin e standarteve të miratuara** – dhe kjo kërkon vëshgues të kualifikuar që janë të aftë të bëjnë vlerësimet përkatëse në bazë të treguese
- **Në matjen e kënaqshmërisë së përfituesve të shërbimit**, që tregon nëse standartet e miratuara plotësojnë kërkesat e komunitetit përfitues, apo nevojitet përmirësim i standarteve aktuale.

Asnjë nga këto nuk ka ndodhur dhe për këtë arsye vlerësimi objektiv i shërbimeve publike do të ishte i vështirë.

Në kushtet e mungesës së instrumentit vlerësues të shërbimeve publike të ofruara nga entet publike në tërësi dhe të atyre lokale në vecanti, ajo që mund të vlerësohet janë të dhënat që ofrohen nga institucionet dhe organizatat e ndryshme që kanë ndjekur performancën e bashkive të reja.

Rritja e financimeve për shërbimet publike me rreth 80% në këto vite, **rritja e numrit të punonjësve të bashkive që ofrojnë shërbime me rreth 40%**, **rritja e numrit të funksioneve dhe shërbimeve që ofrohen nga ana e bashkive, rritja e sipërfaqes nën ujë, pastrimi i disa qindra dhe mijëra km kanale ujitëse dhe kulluese, rritja e numrit të kopshteve dhe cerdheve, rritja e numrit të stacioneve zjarrfikëse (nga 38 në 70 stacione zjarrfikëse), hartimi i planeve vendore (nga 0 bashki në rreth 50 bashki me plane të miratuara dhe 10 të tjera në proces miratimi) krijimi i sporteve të shërbimeve administrative online në të 61 bashkitë, vijimi i ofrimit të shërbimeve bazë në të 373 Njësitë Administrative të trashëguara para reformës, komunikimi**

dhe shqyrtimi online i kërkesave dhe ankesave të banorëve, rritja e transparencës dhe llogaridhënies edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dixhitale, janë disa tregues që shërbimet publike kanë patur përmirësim.

Shumë shërbime janë përmirësuar krahasimisht **jo me ish 373 bashkitë dhe komunat**, por krahasuar me ofrimin e këtyre shërbimeve **nga struktura të qeverisjes qendrore si bordet e kullimit, Zyrat Arsimore, Drejtoritë Pyjore, Prefektët e Qarkut apo Këshillat e Qarkut**. Decentralizimi i funksioneve ka sjellë përmirësim të shërbimeve respektive dhe nëse këtë nuk e pranojmë, duhet të mos pranojmë parimin e subsidiaritetit të sanksionuar në Kartën Europiane të Autonomisë Lokale Të Kongresit të Autoriteteve Lokale pranë Këshillit të Europës, **që shpreh nevojën për ofrimin e shërbimeve nga bashkitë si autoritete më pranë komunitetit**.

Minimalisht duhet të pranojmë përmirësimin e këtyre shërbimeve të decentralizuara, **nëse jemi pro decentralizimit** dhe ushtrimit të më shumë funksioneve nga ana e NJVQV.

Nëse jo i gjithë territori i mbuluar nga bashkitë ka patur përmirësimin e kërkuar, kjo gjë besoj se është e qartë. Shtrirja e shërbimeve në më shumë territor, përmirësimi i cilësisë së tyre po realizohet gradualisht dhe paralelisht me aplikimin e tarifave më të ulëta në zonat përkatëse.

Askush nuk ka pritur që brenda 7 viteve i gjithë territori i vendit do të mbulohej me të gjitha shërbimet publike, dhe të gjitha shërbimet do të ofroheshin me cilësinë e kërkuar nga komuniteti.

Do të ishte një mrekulli nëse 61 bashkitë e reja brenda 7 vitesh do kishin realizuar atë që 373 të tilla nuk e arritën për 25 vjet.

Edhe nëse kjo gjë do të realizohej, kërkesat në rritje të komunitetit, do të shtronin sërish nevojën për përmirësim të mëtejshëm të shërbimeve.

Përfaqësimi

Cështja e përfaqësimit është një aspekt i rëndësishëm i demokracisë vendore. Të zgjedhurit vendore nevojitet të përfaqësojnë zgjedhësit. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy shtyllat kryesore ku mbështetet qeverisja e mirë. **Të përfaqësosh zgjedhësit e tu do të thotë të jesh transparent me ta në të gjithë veprimtarinë dhe t'ju japësh atyre llogari për vendimmarrjen.**

Vecanërisht Këshilli i Bashkisë nevojitet të jetë një organ përfaqësues, por edhe Kryetari i Bashkisë gjithashtu nevojitet të përfaqësojë interesin e zgjedhësve në vendimmarrjen dhe veprimtarinë e vet.

A janë organet e vetëqeverisjes vendore mjaftueshëm përfaqësuese të komuniteteve vendore dhe si ka ndryshuar kjo në lidhje me situatën e përfaqësimit para Reformës Territoriale?

E vështirë të përcaktohet me saktësi sepse **përfaqësimi nuk varet vetëm nga ndarrja territoriale** por edhe nga faktorë të tjerë, që lidhen me **parashikimet ligjore**, me mënyrën e **funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore** dhe vecanërisht nga **zgjedhja që bëjnë Partitë Politike** gjatë hartimit të listave të Këshillave Bashkiake dhe kandidatëve për kryetarë bashkie gjithashtu.

Përfaqësimi para Reformës Territoriale të vitit 2014 nuk është se ka qënë në nivelin e duhur. Mjafton të kujtojmë që :

- Një numur prej **232 (nga 373) Kryetarësh** të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe rreth 3000 këshilltarë në nivel vendor **përfaqësonin vetëm 19% të popullsisë** (i referohemi NJQV-ve me më pak se 5'000 banorë).
- Një numër prej **18 Kryetarësh (nga 373) dhe 620 këshilltarësh (nga 6500)** përfaqësonin **45 % të popullsisë** (i referohemi NJQV-ve me më tepër se 20'000 banorë).

Nëse shohim këto shifra, minimalisht kuptojmë që Reforma Territoriale ka arritur të balancojë përfaqësimin në nivel kombëtar, duke bërë një shpërndarje më të drejtë të numrit të këshilltarëve në përputhje me numrin e banorëve të bashkive të reja. Reforma Territoriale dhe parashikimi i Ligjit 139/2015 ka mundësuar **një përfaqësim më të drejtë në nivel vendi**.

Nëse ka apo jo një shpërndarje të drejtë në nivel bashkish, mbetet për t'u diskutuar çështja e **përfaqësimit brenda komuniteteve të secilës bashki**. Sërish është e vështirë të gjykosh për situatën dhe të arrish në konkluzione të sakta, pa marrë në konsideratë faktorë të tjerë përveç ndarjes territoriale.

Në mandatin e dytë pas reformës (2019 – 2023) përfaqësimi i komuniteteve të NJA është i plotë, në parametra disa herë të përmirësuar krahasuar me mandatin e parë. Në cdo këshill bashkie ka **pjestarë pothuaj nga cdo njësi administrative e bashkive**, vecanërisht nga NJA me popullsi të konsiderueshme. Por **kjo “arritje” nuk ka të bëjë aspak me Reformën Territoriale**, por me fitimin e mandatit të këshilltarit të pothuaj të gjithë pjestarëve të listave të prezantuara nga një parti, lista të cilat përmbanin përfaqësues nga cdo NJA.

Situata në zgjedhjet e ardhëshme do të çojë përsëri në futjen në këshill të pjesëve të para të listave të partive politike dhe jo të listës së plotë të një partie të vetme. **Nëse pjesët e para të listave do të jenë përfaqësuese, atëhere këshillat do jenë përfaqësues mjaftueshëm**, por nëse pjesët e para të listave do kenë vetëm përfaqësues nga qytetet, atëhere banorët e NJA nuk do mund të kenë pjestarët e tyre në këshilla bashkie. Edhe propozimi për **lista të hapura këshilltarësh** nuk e zgjidh këtë çështje nëse konsiderojmë faktin që qytetet kanë numër më të madh votuesish se sa cdo njësi administrative. Nëse duam të kemi më shumë këshilltarë në Këshillat Bashkiake, kjo gjë është e realizueshme nëpërmjet ndryshimit të ligjit 139/2015.

Sigurimi i një përbërje këshilli bashkie me përfaqësues që mbulojnë më shumë territor varet nga vullneti i Partive Politike se sa ato janë të hapura për të prezantuar lista kandidatësh që përfaqësojnë komunitetet.

Gjithsesi përfaqësimi nuk ka të bëjë domosdoshmërisht vetëm me prezencën në këshill të banorëve të cdo zone. Përfaqësimi i komunitetit është i lidhur ngushtë me **qëndrimin e të zgjedhurve vendorë ndaj çështjeve me interes komunitar**. Nëse të zgjedhurit vendorë kuptojnë që janë përfaqësues të komunitetit dhe jo të partive politike, ata **nuk ka nevojë të jenë banorë të cdo zone për të mbrojtur interesat e të gjithë komunitetit**. Edhe nëse një person përfaqëson një zonë të caktuar, ai e ka të pamundur të mbrojë i vetëm, vetëm me votën e tij, interesat e kësaj zone. Ajo që nevojitet për të siguruar përfaqësimin e interesave të komunitetit është kujdesi në përzgjedhjen e kandidatëve të duhur, kualifikimi dhe ndërgjegjësimi i të zgjedhurve vendorë,

garantimi i transparencës dhe llogaridhënies ndaj komunitetit për vendimmarrjen dhe veprimtarinë e organeve të vetëqeverisjes vendore.

Partitë Politike nuk mund të ankohen për mungesë përfaqësimi të komuniteteve vendore në këshillat bashkiake. Ato janë përgjegjësit e vetëm për mungesën e këtij përfaqësimi. Komunitetet kanë të drejtën të ankohen ndaj partive politike për mënyrën se si ato hartojnë lista militantësh dhe pasi i futin këta militantë në këshilla, ankohen për mungesë përfaqësimi.

Partitë politike përzgjedhin kandidatët për kryetarë dhe anëtarë këshillash dhe fituesit janë mes tyre të përzgjedhur nga njëra apo tjetra forcë politike. Nëse të zgjedhurit nuk janë mjaftueshëm të përgjegjshëm në ushtrimin e funksionit dhe kompetencave të tyre dhe në veprimtarinë e tyre nuk përfaqësojnë interesat e komunitetit, pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë bie mbi partitë politike.

Decentralizimi

Decentralizimi i funksioneve drejt NJVQV është një proces që ndodh natyrshëm dhe që do të vazhdojë të ndodhë edhe në të ardhmen. Nevoja për decentralizim të shërbimeve drejt strukturave që janë më afër komunitetit (parimi i subsidiaritetit) lidhet me pamundësinë e strukturave qendrore për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe nga ana tjetër me kërkesat në rritje të komuniteteve për shërbime të përmirësuara.

Qeveritë nuk decentralizojnë funksione dhe kompetenca sepse kanë dëshirë, por sepse e kanë të pamundur ‘t’i mbajnë” ato. Por nëse procesi i decentralizimit është i natyrshëm, pengesa e vetme e tij është copëzimi në shumë NJVQV i cili e bën të pamundur atë.

Jo vetëm në Shqipëri, por kudo në vende demokratike, “beteja” ndërmjet kërkesës së NJVQV për më shumë të drejta, funksione dhe kompetenca dhe tendencës së Qeverive Qendrore për të mos decentralizuar funksionet, është një proces i natyrshëm.

Argumenti kryesor që përdor qeveria qendrore për mosdecentralizim është mungesa e kapaciteteve të NJVQV për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave.

Njësitë vendorë të mëdha, të konsoliduara financiarisht dhe me burime të mjaftueshme njërzore përfitojnë më shumë nga procesi i decentralizimit. Decentralizimi i funksioneve të reja (arsimit parashkollor, shërbimi zjarrfikës, administrimi i pyjeve dhe kullotave, administrimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit, mirëmbajtja e rrugëve rurale, administrimi i fondit social dhe i qendrave sociale, i konvikteve, parkimeve publike, etj) jo më shumë se 6 muaj pas fillimit të zbatimit të Reformës Territoriale në vitin 2016, e konfirmron më së miri këtë fakt.

Konsolidimi i ushtrimit të funksioneve të decentralizuara dhe decentralizimi i funksioneve të reja nevojitet të ecin paralelisht me qëllim mos mbingarkimin e bashkive me funksione dhe kompetenca të cilat nuk mund t’i ushtrojnë dot.

Decentralizimi asimetrik apo delegimi i kompetencave është parë gjithashtu si një instrument për mosndërprerjen e procesit të decentralizimit

Bashkitë e vogla vs bashkitë e mëdha

Vërrehet ndryshim ndërmjet performancës së bashkive të vogla dhe të mesme me ato të konsideruara të mëdha. Aplikimi i disa treguesve kryesorë, tregon se **bashkitë e mëdha performojnë më mirë në drejtim të realizimit të të ardhurave, kryerjes së investimeve dhe ofrimit të shërbimeve më të mira dhe eficiente ndaj komunitetit.**

Ne kemi analizuar vetëm disa tregues duke ju referuar të dhënave zyrtare të MFE

○ **Eficienta në ofrimin e shërbimeve**

Njësitë e vogla vendore janë shoqëruar në disa raste me mungesë efieçence në ofrimin e shërbimeve publike. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore me **numër shumë të vogël popullsie dhe me burime e asete tepër të kufizuara, janë evidentuar në shumicën e rasteve me paaftësi për të kryer funksionet dhe ofruar shërbimet publike të përcaktuara nga kuadri ligjor**, mungesë të aftësisë për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, përdorim të të ardhurave buxhetore për shpenzime administrative dhe varësi pothuajse absolute për shumicën e NJVQV-ve nga transfertat financiare qeveritare.

Përsa i përket efieçencës së kryerjes së shërbimeve, nga raporti i të dhënave në shkallë kombëtare për shpenzimet e personelit para reformës (ku funksionin 308 komuna dhe 65 bashki) rezultonte se, **235 Komuna dhe Bashki (nga 373)** kishin një kosto personeli shumë të lartë pra **mbi 50% të shpenzimeve**. Shumica e NJVQV-ve nuk kryente asnjë investim me të ardhurat e veta por ishin të varura totalisht nga grantet e buxhetit të shtetit. Në vitet e fundit, megjithëse situata është ndjeshëm më e përmirësuar, janë konstatuar se, **rreth 20 bashki aktuale që futen në grupin e bashkive të vogla dhe të mesme, kanë të njëjtat vështirësi në zbatimin e disa programeve buxhetor**, që pak a shumë nënkuptojnë që funksionet e tyre nuk i plotësojnë në nivelin e duhur dhe për arsye të paaftësive të tyre fiskale ndjejnë vështirësi.

Nëse këtij numri do t'i shtonim edhe 33 të tjera, atëherë do të kishim rreth 53 të tilla.

Në këto kushte është e paimagjinueshme **copëzimi i bashkive dhe një tendencë për fragmentim të mëtejshëm do të ishte inefficiente dhe e dëmshme.**

○ **Investimet publike**

Riorganizimi i njërive të vetëqeverisjes vendore ka krijuar mundësinë për të ofruar një shpërndarje të investimeve në mënyrë më efieçente, kjo veçanërisht kur flasim për arsimin, infrastrukturën rrugore, menaxhimin e mbetjeve urbane, etj.

Në vitin 2021, investimet publike të financuara nga vetë bashkitë janë rritur **me mbi 3 herë ose 6.3 miliard lekë** më të larta krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës). Por edhe në këtë rast, ekzistojnë diferenca në performancën individuale veçanërisht ndërmjet bashkive të mëdha dhe të vogla në drejtim të investimeve.

Konkretisht, nëse do të analizonim 61 bashkitë e vendit, rezulton se, në rreth 24 bashki shpenzimet për investime **zënë 1 % të totalit të shpenzimeve në bashki** si: **Delvinë, Devoll, Dibër, Shijak, Cërrik, Libohovë, Has, Rogozhinë, Kolonjë, Mallakastër, Mat, Peqin, Përmet, Pukë, Skrapar, Poliçan, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Fushë-Arrëz, Konispol, Vau Dejës, Pustec dhe Klos.**

Vlen të theksojmë se pothuajse të njëjtat bashki paraqiten edhe me kapacitet më të ulët fiskal në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Nëse do të shtonim edhe 33 bashki të tjera të vogla, atëherë ky numër do të shkonte në 57 bashki ose 60% të numrit total të bashkive !!

○ **Të ardhurat**

Bashkitë e mëdha mbi 40% të buxhetit të tyre e sigurojnë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ku përmendim këtu Bashkinë Tiranë e cila përfiton të ardhura nga buxheti i shtetit vetëm 18% të buxhetit të saj, ndërsa pjesën tjetër e siguron nga të ardhurat e veta.

Edhe në kriterin e autonomisë fiskale që lidhet me raportin e të ardhurave të veta ndaj buxhetit të bashkisë, **dominojnë si njësi me aftësi të fortë fiskale bashkitë e mëdha dhe bashkitë e vogla rezultojnë me aftësit të dobëta fiskale.**

Për vitin 2021, të ardhurat e veta të realizuara nga bashkitë janë gjithsej rreth **29.5 miliard lekë**, Nga kjo analizë rezulton se për **21 bashki** (të vogla dhe të mesme) të ardhurat e veta zënë **deri në 0.5 %** të totalit të të ardhurave vendore.

Pra, evidentohet fakti se, bashkitë e vogla kanë një kapacitet të ulët fiskal dhe si rrjedhojë fragmentizimi akoma më shumë i tyre vetëm do ta përkeqësonte situatën.

Nëse do të shtonim edhe 33 bashki, ky numër do të shkonte në 54 bashki ose në 57% të numrit total të bashkive.

Nëse do ti referohemi totalit të të të ardhurave të veta vendore për vitin 2021, bashkitë grupohen si më poshtë:

- **Me të ardhura në shumën 4 -50 milion lekë** paraqiten **19 bashki** (Kolonjë, Skrapar, Mirditë, Bulqizë, Kurbin, Konispol, Pukë, Përmet, Delvinë, Tropojë, Tepelenë, Poliçan, Klos, Fushë-Arrëz, Has, Memaliaj, Këlcyrë, Libohovë, Pustec).
- **Me të ardhura në shumën 50-100 milion lekë** paraqiten 17 bashki (Mallakastër, Devoll, Cërrik, Kuçovë, Maliq, Divjakë, Dibër, Vau i Dejës, Mat, Malësi e Madhe, Selenicë, Belsh, Finiq, Prrenjas, Gramsh, Dropull, Peqin).
- **Me të ardhura në shumën 100-500 milion lekë** paraqiten 18 bashki (Kamëz, Sarandë, Lushnjë, Himarë, Kavajë, Berat, Lezhë, Vorë, Pogradec, Krujë, Patos, Roskove, Kukës, Gjirokastër, Shijak, Ura Vajgurore, Librazhd, Rrogozhinë).
- **Me të ardhura në shumën >500 milion lekë**, 7 bashki (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Korçë)

Shifrat e mësipërme flasin vetë dhe skanë nevojë as për komente dhe as për analiza më të thelluara. **Bashkitë e mëdha sigurojnë efektivitet dhe efikasitet më të lartë se bashkitë e vogla. Copëzimi i bashkive sjell më shumë vështirësi dhe problematika për bashkitë e vogla dhe do të përbëntë një kthim pas dhe përkeqësim të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave nga ana e bashkive dhe përkeqësim shërbimesh për qytetarët.**



Një çështje e rëndësishme për t'u konsideruar nga ana e Komisionit është përgjigja e pyetjes : “**A është ky momenti i duhur për vlerësim dhe rishikim të Reformës Territoriale?**”

Nga fillimi i aplikimit të ndarjes së re territoriale pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, kanë kaluar pak më shumë se 7 vjet. Për një reformë të tillë që transformoi rrënjësisht organizimin dhe administrimin territorial të qeverisjes vendore, **7 vite janë të pa mjaftueshme për të dhënë një vlerësim objektiv.**

Po kalon mandati i dytë i të zgjedhurve vendorë pas Reformës Administrative Territoriale dhe këto **dy mandate kanë qënë atipike**, duke e bërë akoma më të vështirë vlerësimin real të efekteve të kësaj reforme. Konkretisht :

- Mandati i parë pas reforme, ai i viteve 2015-2019 ishte mandati i parë që në vendin tonë të zgjedhurit e rinj vendorë (Kryetarë dhe Këshilla Bashkie) do të administrojnë territore me konfigurim të ri mes vështirësish të reja.
 - **Organizimi i bashkive të reja** ishte sfida e parë për të sapo zgjedhurit vendorë.
 - **Organizimi i Njësive Administrative** kryhej për herë të parë dhe pa përvojën e nevojshme.
 - **Krijimi i strukturave dhe buxheteve të reja**, vecanërisht në mesin e vitit 2015 dhe përgatitja e buxheteve të reja për vitin 2016 kërkontë angazhim më të madh.
 - **Rishikimi i paketave fiskale dhe buxheteve** të ish njësive dhe ish ndërmarrjeve publike
 - **Procesi i amalgamimit të njësive** pati efektet e veta në administrimin e bashkive të reja vecanërisht në vitet e para.
 - **Administrimi i kontratave dhe aseteve të bashkive të reja** të trashëguara nga ish bashkitë dhe komunat ngarkoi me punë administratën e re vendore.
 - **Riorganizimi i institucioneve në vartësi dhe i ndërmarrjeve publike** si dhe krijimi i atyre të përbashkëta
 - **Transferimi i funksioneve të reja** kërkonte kohën dhe angazhimet e nevojshme të 61 NJVQV për marrjen e kompetencave të reja, **krijimin e strukturave përkatëse dhe ushtrimin e funksioneve të reja.**
 - **Hartimi dhe miratimi i ligjeve sektoriale** kërkonte konsultim dhe angazhim të të zgjedhurve vendorë krahas atyre të ministrive të linjës.
- **Mandati i dytë , ai i viteve 2018-2022** është sërish një madat me specifika të pandeshura më parë.
 - **Bojkoti i opozitës** krijoi NJVQV të drejtuara **Kryetarë Bashkie përfaqësues të një force politike**
 - **Këshillat Bashkiake u krijuan me përfaqësues të një force politike** (me ndonjë përjashtim të rrallë që nuk ndryshon shumicën e theksuar të dominimit të një force politike)
 - **Kryetarë bashkie dhe këshilla bashkia të përputhura politikisht**, në të gjitha bashkitë
 - **Vendime të këshillit që kryesisht merren lehtësisht** me shumica të cilësuar, sipas propozimeve të kryetarëve.
 - **Mungesa debati** dhe diskutimi në këshilla bashkie.

- **Mungesë e rolit monitorues dhe vendimmarrës të këshillit**

Është e vështirë të arrish në konkluzione objektive nëpërmjet analizave të vetëqeverisjes vendore gjatë këtyre dy mandateve.

Problematikat dhe vështirësitë me të cilat u ndeshen NJVQV gjatë mandatit të parë të pas reformës, duket se kanë të bëjnë më shumë me vështirësitë e përmendura më lart se sa me reformën në vetvete.

“Arritjet” e mandatit të dytë duket se kanë të bëjnë më shumë me faktin që vështirësitë e amalgamimit u tejkaluan në mandatin e parë, duke ja bërë më të lehtë punën të zgjedhurve të rinj vendorë.

Dallimi midis efekteve të Reformës, të legjislacionit dhe menaxhimit të bashkive dhe NJA

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 7 vite, **nuk ka akoma një vlerësim të plotë dhe të pavarur të reformës Administrative Territoriale** që do të mund të përcaktonte nëse kjo reformë **ka qënë e efektshme, nuk ka qënë e efektshme apo ka qënë pjesërisht e efektshme** dhe që ka nevojë për përmirësime.

Nëse një studim i tillë nuk ekziston, ka **analiza dhe studime të pjesëshme**, që lidhen me funksione apo kompetenca të caktuara, të analizuar **në bashki apo grupe bashkish të vecanta**.

Gjetjet dhe rekomandimet si dhe analizat përkatëse, në asnjë nga raportet e prodhuara, **nuk konkludojnë në deklarime të llojit “Reforma ka qënë e suksesshme” apo “Reforma ka qënë e dështuar”**. Në të gjitha raportet shprehet **vlerësim për arritjet dhe parashtrohen gjetje dhe rekomandime për përmirësim të performancës së NJVQV**.

Është e vështirë të arrish në konkluzione të tilla pa përcaktuar **një numër treguesish që mbulojnë të gjitha aspektet e vetëqeverisjes vendore, që janë në gjendje të matin efektet e reformës, të shkëputura nga të tjerë faktorë me ndikim në performancën e bashkive dhe që lidhen me njohjen dhe zbatimin e legjislacionit, apo me aftësitë menaxhuese të kryetarit të bashkisë dhe drejtuesve të tjerë vendorë**.

Në të gjitha çështjet për të cilat atakohet sot Reforma Territoriale, është e vështirë të mos gesh ndërthurje të të tre faktorëve.

Numri i punonjësve – reforma apo vendimmarrje e gabuar e këshillit apo nevojë për përmirësim shërbimi e parashikuar nga ligji

Mungesa e kompetencave e NJA – pasojë e reformës, mangësi e ligjit apo mungesë vullneti e kryetareve dhe këshillave për delegi kompetencash

Mungesa e përfaqësimit të zonave rurale në këshilla – pasojë e reformës, e ligjit apo e partive politike

Shërbime të shtrira në territor dhe të përmirësuara/përkeqësuara – efekt I reformës, I ligjit apo I angazhimit/mosangazhimit të drejtuesve vendorë

Në kushtet e mungesës së një analize të plotë, ta pavarur dhe të thelluar të efekteve dhe pasojave pozitive dhe negative të reformës territoriale në performancën e bashkive, ajo që na mbetet është analiza mbi bazën e të dhënave që kemi në dispozicion.



A mund të rishikohet ndarja territoriale?

Sigurisht që ndarja territoriale, cilado qoftë ajo nuk është as e paprekshme dhe as e përherëshme. Ajo mund të përmirësohet në funksion të shërbimeve më të mira për komunitetin, kur ajo vjen si nevojë, si kërkesë e komunitetit dhe si domosdoshmëri për përmirësim shërbimesh komunitare.

Gjithsesi në cdo rast, **nevojitet që të përcaktohen paraprakisht kriteret që jo vetëm përcaktojnë se cilat ndryshime janë të mundëshme, por edhe që garantojnë që ndryshimi do të sjellë përmirësim dhe jo përkeqësim të shërbimeve publike dhe përfaqësim më të mirë të interesave të komuniteteve përkatëse.**

- Duhet konsideruar një fakt i rëndësishëm që është i njohur botërisht:
 - **Bashkimi është shprehje e një vullneti pozitiv** dhe bashkon forcat, kapacitetet dhe mundësitë për të vepruar së bashku në përmirësimin e situatës dhe vjen si vullnet i dyanshëm apo shumëanshëm për bashkëpunim.
Nëse dy ose më shumë bashki vendosin të bashkohen, ato pas bashkimit kanë kapacitete të shtuara. Psh nëse secila bashki ka nga një ndërmarrje shërbimesh publike, bashkia e re do të ketë dy të tilla, të cilat mund të administrohen si të vecanta apo të bashkohen.
 - **Ndarja, zakonisht vjen si rezultat i përkeqësimit, i acarimit, i degradimit të vazhdueshëm dhe përkeqësimit të një situatë, për të cilën kanë shteruar të gjitha përpjekjet dhe mundësitë në dispozicion të palëve, të cilat konkludojnë se nuk mundet të vazhdojnë të ekzistojnë si një e tërë.**
Nëse një bashki coptohet në dy ose më shumë pjesë, ajo rezikon që të mos garantojë mjaftueshëm burimet e nevojshme për secilën pjesë. Psh nëse bashkia ka një ndërmarrje publike, ndarja në dy apo më shumë bashki rezikon të lerë një apo disa bashki pa instrumentin përkatës të ofrimit të shërbimit.

Ne akoma nuk kemi provuar ndarjen në këto më shumë se 30 vite.

Kemi bashkuar rrethet për të krijuar qarqet në vitin 2000

Kemi bashkuar vullnetarisht dy komuna në vitin 2003

Kemi bashkuar 373 bashki dhe komuna për të krijuar 61 bashki të reja në vitin 2014

Nuk kemi asnjë eksperience ndarjesh dhe nuk njohim pasojat që vijnë prej saj.

Ndarja është një proces më i vështirë se bashkimi. Nevojitet rast pas rasti një analizë e thellë dhe e detajuar se çfarë do të ndodhë me pjesët që ndahen dhe duhet përgjigje për shumë pyetje që lindin natyrshëm:

- A do të mund të ketë cdo pjesë e krijuar si bashki më vete, një qendër ofrimi shërbimesh publike për vete dhe për pjesën tjetër?
- A është kjo qendër e re me më shumë mundësi së sa qendra e bashkisë nga e cila vjen ndarja ?
- A ka kjo pjesë burimet e nevojshme financiare që do të garantojnë në vazhdimësi mundësinë për ushtrimin e funksioneve të veta?
- A garanton secila pjesë burimet e nevojshme njerëzore për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave që i jep ligji ?
- A ka cdo pjesë e ndarë ndërmarrje dhe institucione në varësi për ushtrimin e funksioneve të veta?
- A ka cdo pjesë e re e krijuar mjetet dhe paisjet e nevojshme që nevojiten për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta?
- Si ndikon copëzimi i rrjetit rrugor, i sistemeve vaditëse, i fondit të pyjeve dhe kullotave, i rrjetit të furnizimit me ujë, i shërbimit zjarrfikës, i shërbimeve veterinerë dhe bujqësore, i tregjeve dhe thertoreve, i transportit publik, i burimeve natyrore, minerare, ujore, etj.
- A e dëmton ndarja funksionimin e bashkisë mëmë nga e cila ndahet dhe kush është raporti midis dëmtimit të një bashkie dhe përfitimit të tjetrës?
- Cilat janë mundësitë e shtuara të njësisve më të vogla krahasuar me njësinë e madhe për ofrimin e shërbimeve më të mira dhe zhvillimin ekonomik vendor?
- A ekzistojnë institucionet e dekoncentruara në këto pjesë të reja, të nevojshme për ushtrimin e funksioneve në fusha të përbashkëta të veprimtarisë (zyra arsimore, sigurime shoqërore, zyra pune, kadastra, zyra konsulence bujqësie e blegtorie, etj.)

Ne gjykojmë të domosdoshme që krijimi i një bashkie të re lidhet domosdoshmërisht me plotësimin e disa kriterëve paraprake që nevojitet të plotësohen vec e vec dhe të gjitha së bashku.

Mes tyre do rendisim :

- **Një bashki nevojitet të jetë një Zonë Funksionale** dhe ketë një qendër të një Zone Funksionale që jo vetëm ka zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të vet, por shërben edhe si qendër zhvillimi ekonomik dhe mbështetje për zhvillimin e territoreve që përfshin bashkia. **Ndryshe, për çfarë i nevojitet një fshati apo nje grupi fshatrash që të administrohet nga një fshat tjetër apo një grup tjetër fshatrash?**
- Shkëputja nga bashkia prej së cilës ndahet **të mos dëmtojë zhvillimin ekonomik të bashkisë përkatëse** (psh rasti kur pjesa që ndahet përmban gjithë zonën e bregdetit, të gjithë zonën turistike, të gjithë fondin pyjor, etj. të bashkisë ekzistuese duke dëmtuar rëndë bashkinë nga e cila ndahet).

- Të ketë **numër biznesesh dhe numër banorësh** që justifikojnë krijimin e një bashkësie të re që do të mund të administrohet më vete. (Nuk mund të ketë bashki pa biznese, të cilat janë instrumenti bazë i zhvillimit ekonomik të zonës dhe burimi i të ardhurave të bashkisë me qëllim ofrimin e shërbimeve publike)
- Të ketë **distancë nga qendra e bashkisë** prej së cilës ndahet për të krijuar një bashki të re prej (me qëllim sigurimin që nuk coptojmë në mënyrë artificiale territore të zhvilluar në mënyrë harmonike dhe të vazhdueshme, por zona të vecuara që kanë patur vështirësi marrje shërbimi për shkak të distancës dhe infrastrukturës së keqe)
- Të ketë **territor që justifikon ndarjen** nga bashkia të cilës i përket (nëse territori që ndahet është më vogël se ai i bashkive aktuale, ai mund të administrohet më mirë nga bashkia ekzistuese e cila është konsoliduar gjatë këtyre 7 viteve)
- Të ketë **numur nxënësish të arsimit parauniversitar** që nuk ka pësuar rënie e të ndjeshme gjata 10 viteve të fundit.
(numri i nxënësve tregon realisht lëvizjen e popullsisë nga zonat pa perspektive zhvillimi dhe pa burime të mjaftueshme, drejt zonave me tendencë zhvillimi të qëndrueshëm)
- Të jetë e garantuar **mbështetja me staf të kualifikuar** (lehtësisht e verifikueshme nëse personeli mësimor dhe shëndetësor që ofron shërbimet në këtë territor është vendas apo vjen nga zonat urbane? A ka banorë të zonës me profesione jurist, inxhinier, arkitekt, topograf, ekonomist, agronom, veteriner, punonjës social, etj. që sot punojnë në bashkia fqinje dhe që në rast ndarje do mund të plotësojnë personelin e nevojshëm?)
(nëse personeli do të sigurohet nëpërmjet ish bashkisë edhe pas ndarjes, është më mirë që kjo ndarje të mos kryhet, sepse do të ishte një kthi pas tek ish komunat)
- Pjesa që ndahet të ketë **traditë, kulturë dhe vecori që nuk e lidhin ngushtësisht me bashkinë** që ndahet, madje ndarja ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e këtyre vlerave.

Kriteri kryesor është marja e pëlqimit të komunitetit

Qarku

Konstatohet lehtësisht që Këshillat e Qarqeve janë në një moment të mosushtrimit të funksioneve të tyre

Gjendja në të cilën ndodhen sot Këshillat e Qarqeve nuk gjykohet të ketë lidhje me Reformën Territoriale. Nëse para Reformës një Këshill Qarku nevojitej të koordinonte ndërmjet rreth 30 njësive (bashki dhe komuna), sot një Këshill Qarku nevojitet të luajë rolin e koordinuesit të veprimtarisë në territore të organizuara në rreth 5 NJVQV të nivelit të parë. Reforma ka lehtësuar punën e Këshillave të Qarkut, dhe me sa duket ky lehtësim ka cuar deri në pasivitet.

Duhet marrë në konsideratë edhe fakti që bashkitë e reja, kryesisht ato të mëdha, nuk ndjejnë nevojën direkte të Qarkut, për shkak të mundësive të veta dhe kapaciteteve të shtuara.

Këshilli i Qarkut nevojitet të luajë një rol të ri në kushtet e reja, rol i cili nuk është kuptuar sa dhe si duhet. Këshilli i Qarkut nuk mund të mirëmbajë rrugët rurale, sepse ato tashmë janë rrugë të

brendëshme të bashkive të reja. Këshilli i Qarkut nuk mund të mirëmbajë objektet shkollore të komunave, sepse në vend të tyre ka bashki që janë në gjendje ta bëjnë këtë gjë vetë.

Por këshilli i Qarkut mund të kryejë funksione dhe të ushtrojë kompetenca të deleguara nga ana e qeverisë, (delegimi nga lart-poshtë) apo nga bashki të vecanta (apo delegimi nga poshtë-lart), si dhe mund të identifikojë shërbime që kanë të bëjnë me më shumë se një NJVQV si psh trajtimi i mbetjeve urbane në nivel rajonal, administrimi i ndëmmarrjeve rajonale të UK, hartimi dhe zbatimi i programeve rajonale që lidhen me mjedisin, me pyjet dhe kullotat, me turizmin, zhvillimin ekonomik të rajonit, me riorganizimin e arsimit profesional në nivel qarku, transportin publik në territorin e qarkut, etj.

Kjo gje mund të realizohet nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit, qartësisht të funksioneve dhe kompetencave dhe krijimit të hapësirave të nevojshme për ushtrimin e tyre.

Kalimi nga 12 qarqe që përbëjnë nivelin e dytë të qeverisjes vendore me 61 bashki në nivelin e parë (mesatarisht 5 bashki në qark), në 6 qarqe për 94 bashki (mesatarisht 15-16 bashki në qark) apo në 4 qarqe (mesatarisht 23-24 bashki për qark) nuk e ndihmon procesin e vënies në funksion të këshillave të qarqeve

Ndryshim/përmirësim legjislacioni

Një sërë problematikash të evidentuara në performancën e NJVQV, megjithëse deklarohen si efekte të Reformës Territoriale, kërkojnë zgjidhje që kanë të bëjnë me përmirësim të mundëshme të legjislacionit.

Përmirësimi i legjislacionit është një proces i vazhdueshëm që lidhet me konstatimet përkatëse, me evidentimin e nevojave, propozimin e zgjidhjeve, konsultimin me të zgjedhurit dhe drejtuesit vendorë dhe vendimmarrjen përkatëse.

Përmirësim të mundëshme ligjore dhe mundësia e krijimit të mekanizmave dhe instrumentave efektivë për të garantuar një mbështetje më të madhe për NJVQV, sipas rekomandimeve të paraqitura në këtë raport, rekomandohet t'i propozohen Ministrisë së Brëndëshme si mundësi për përfshirje të tyre në Strategjinë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Vendore 2023-2030 që është në proces hartimi, me qëllim konsolidimin e vetëqeverisjes vendore drejt një Vetëqeverisje Vendore të Hapur, që ofron shërbime cilësore për komunitetin. Konkretisht:

- ✓ Përfaqësimi i banorëve të NJA dhe zonave rurale në Këshillat Bashkiake mund të përmirësohet nëpërmjet rishikimit të numrit apo mënyrës së zgjedhjes së Këshillave Bashkiake dhe strukturave komunitare.
- ✓ Forcimi i rolit të Këshillave Bashkiake në mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së ekzekutivit duhet sanksionuar në ligjin organik nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Vijimi i decentralizimit dhe vecanërisht decentralizimit asimetric duhet të sigurojë decentralizim funksionesh dhe kompetencash të reja për bashkitë që zotërojnë kapacitetet e nevojshme për administrimin e tyre.

- ✓ Shtimi i mbështetjes financiare për bashkitë nëpërmjet shtimit të taksave të ndara si dhe rritjes së përqindjes së taksave të ndara në favor të bashkive, vecanërisht rentës minerare dhe tatimit për të ardhurat personale të parashikuara në Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe sigurimi i mbështetjes për krijimin e kadastrës fiskale.
- ✓ Rritja e kompetencave të administratorëve dhe forcimi i rolit të NjA si dhe e strukturave komunitare në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet përcaktimit në ligj dhe delegimit të më shumë kompetencave nga ana e kryetarëve dhe këshillave bashkiake.
- ✓ Rishikimi/Liberalizimi i nivelit të pagave të administratës së bashkive me qëllim sigurimin e një administrate të aftë dhe të mirëpaguar, vecanërisht në bashkitë me numër të vogël banorësh.
- ✓ Qartësimi i kompetencave të NJVQV me qëllim shmangien e mbivendosjeve me strukturat e dekoncentruara vendore, vecanërisht në lidhje me inspektoriatet.
- ✓ Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit sektorial në fushat e funksioneve të bashkive.
- ✓ Rishikimi i rolit dhe kompetencave të qarkut në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Rajonal si dhe me perspektivën eventuale të afrimit me BE-në
- ✓ Të tjera përmirësime që diktohen nga nevoja për një e-qeverisje vendore të hapur dhe transparente.

Konkluzione

Nëse nevojitet një opinion në lidhje me rishikimin e ndarjes territoriale, opsionet e mundëshme janë :

- Copëzim i mëtejshëm i bashkive dhe shtimi i numrit të bashkive me bashki të vogla të dala si pjesë të atyre ekzistuese
- Bashkim i bashkive të konsideruara “të vogla” rreth atyre fqinjë më të mëdha dhe të konsoliduara, duke zvogëluar numrin e bashkive dhe duke cuar në krijimin e bashkive më të mëdha.
- Dhënia e më shumë kohë bashkive aktuale për konsolidim të mëtejshëm dhe përmirësim të performancës së tyre.

Bazuar në gjetjet dhe analizat e mësipërme, rekomandimi ynë do të ishte **realizimi i një studimi të plotë dhe konsultimi publik me komunitetet e të ashtuquajturave “bashki të vogla” me qëllim konsiderimi i mundësisë së shkrirjes së tyre dhe bashkimit me bashkitë fqinje, duke krijuar bashki të mëdha, që ofrojnë më shumë mundësi dhe shërbime cilësore si dhe garantojnë zhvillim të qëndrueshëm vendor.**

Në kushtet e :

- Kohës së kufizuara të ushtrimit të veprimtarisë së 61 bashkive vetëm në 7 vite, që përfaqësojnë më pak se dy mandate atipike të të zgjedhurve vendorë
- Mungesës së një studimi të plotë dhe të pavarur të efekteve të Reformës Territoriale të vitit 2014 dhe atyre që mund të sillte një riorganizim territorial.

- Mungesës së studimeve dhe analizave të thelluara të zonave që mund të përfshihen në ndryshimin e ndarjes së territorit
- Mungesës së kohës së mjaftueshme në dispozicion të Komisionit për të marrë mendimin e komuniteteve vendore që mund të preken nga riorganizimi.
- Mungesës kohës së mjaftueshme për ndjekjen e të gjitha procedurave të parashikuara nga ligji për vendimmarrje për rishikim të ndarjes territoriale
- Afrimit të zgjedhjeve vendore të pranverës së vitit 2023

Rekomandojmë :

1. Vazhdimin e përpjekjeve të përbashkëta të të gjithë aktorëve qendrorë dhe lokalë, vendas dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, për konsolidimin e 61 NJVQV aktuale drejt krijimit të bashkive që realizojnë veprimtarinë e tyre bazuar në Parimet e Qeverisjes së Hapur, në parimin e Vetëqeverisjes Autonome që vepronë në interes të komuniteteve që përfaqësojnë, që mbështesin zhvillimin e ekonomik vendor dhe ofrojnë shërbime cilësore për komunitetin.
2. Qartësimi i funksioneve dhe kompetencave të Këshillave të Qarqeve si njësi vendore të nivelit të dytë me rol të vecantë në zhvillimin rajonal si dhe garantimi i mbështetjes së nevojshme për 12 Këshillat e Qarqeve për ushtrimin efektiv të veprimtarisë së tyre në mbështetje të 61 NJVQV dhe të Qeverisë Qëndrore po ashtu.
3. Konsultimin me komunitetet vendore, me të zgjedhurit dhe drejtuesit vendorë si dhe me ekspertë dhe OSHC të gjetjeve dhe nevojave për përmirësim të legjislacionit dhe propozimin e tyre për t'u përfshirë në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Vendore 2023-2030.
4. Trajtimin rast pas rasti nga ana e Qeverisë dhe e Kuvendit e kërkesave të vecanta për rishikim kufijsh ndërmjet fshatrave, për përkatësinë e fshatrave apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për territore dhe çështje pronësie ndërmjet NJVQV.
5. Sigurimin e mbështetjes nga partnerët tanë ndërkombëtarë për realizimin e një studimi të plotë dhe të pavarur të efekteve të Reformës Territoriale brenda një periudhe 3-5 vjecare me qëllim marrjen në konsideratë të gjetjeve dhe rekomandimeve për përmirësime të mundëshme të ndarjes territoriale në të ardhmen.

Artan Shkëmbi

Adelina Farrici

Ekspertë të Vetëqeverisjes Vendore